



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 09 datë 25.09.2025

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “NDËRTESE E RE 1 KAT
PËR QENDRËN BACK UP SCADA DCC-B”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË
VLORË

Në mbështetje të neneve 27, 28, 39 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtesë e re 1 kat për qendrën Back Up Scada DCC-B”, me vendndodhje në Bashkinë Vlorë, me subjekt zhvillues Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave i bashkëlidhet këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuesit vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Vlorë;
4. Vendimi Nr. 03, datë 20.11.2024 i Këshillit Kombëtar të Territorit për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i një ndërtese të re për qendrën Backup - Scada Dcc-B”, me vendndodhje në Bashkinë Vlorë, me subjekt zhvillues Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a, shfuqizohet.
5. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Punëve të Brendshme dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 23/12/ 2025